

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"HORIZON" SH.P.K.**



**NENI 1
THEMELIMI**

1.1 Shoqëria "HORIZON" Sh.P.K më poshtë e quajtur "*Shoqëri*" themelohet nga ortakët:

1. *Vasileios Stachos*, shtetas grek, i biri i Theodoros, lindur në Glifada te Atikes, Greqi, me 1 Qershor 1973, banues ne Rruga "Komuna e Parisit", Tirane, Shqiperi, mbajtës i pasaportes Nr. O 819701;

2. *Ilias Katsouris*, shtetas grek, i biri i Panajotis, lindur në Samos, Greqi, me 13 Qershor 1961, banues ne Athine, Greqi, mbajtës i pasaportes Nr. T 299702;

3. *Mirela Tesho*, shtetase shqiptare, e bija e Kristos, lindur me 7 Gusht 1969, ne Tirane, banuese ne Rruga "Ismail Qemali", Tirane, Shqiperi, mbajttese e pasaportes Nr.1900189;

**NENI 2
EMERTIMI**

2.1 Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar ka emertimin "HORIZON" Sh.P.K, emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj dhe me te cilin shoqeria do te paraqitet ne cdo dokumentacion te saj dhe ne marredheniet me te tretet.

2.2 Ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe do te nxjerre Shoqeria, ky emertim i saj do te shoqerohet duke u shenuar ne te dhe Selia Qendrore.

NENI 3

3.1 Aktivitetin e saj Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "HORIZON" Sh.P.K., e shtrin ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

**NENI 4
SELIA**

4.1 Selia e Shoqërisë është në adresen: Rruga "Ismail Qemali", Godina Samos Tower, kati i II, Tirane, Shqiperi.

NENI 5

5.1 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "HORIZON" Sh.P.K., eshte Person Juridik Shqipetar dhe aktivitetin e saj e bazon ne legjislacionin vendas dhe kryesisht: Ne Ligjin 7632, date 04.11.1992 " Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", ne Ligjin 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", ne Ligjin 7667, date 28.01.1993 'Per Regjistrin Tregtar", si dhe ne Aktin e Themelimit dhe te Statutit te saj.

NENI 6

- 6.1 Personalitetin juridik shoqëria e fiton mbi bazen e Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si dhe të regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate.

NOTER
TIRANË

NENI 7

- 7.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet.
- 7.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë mund të zgjatet ose të ndryshojë me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

NENI 8 KAPITALI

- 8.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, tërërisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët përpara regjistrimit të Shoqërisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë.
- 8.2 Kapitali është ndarë në 100 (njëqind) pjesë, secila me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë shqiptare.
- 8.3 Pjesët e kapitalit zotërohen nga ortakët si më poshtë:
- | | | |
|---|--------------------------|-------------------------------|
| - | Ortaku Vasileios Stachos | 57,5% të pjesëve të kapitalit |
| - | Ortaku Ilias Katsouris | 37,5% të pjesëve të kapitalit |
| - | Ortaku Mirela Tesho | 5% të pjesëve të kapitalit |

NENI 9 OBJEKTI

- 9.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:
- Te sigurojë shërbime për Shoqëritë dhe/ose individët, në lidhje me pajisjet dhe infrastrukturën e funksionimit të Teknologjisë së Informacionit;
 - Te sigurojë zgjidhje teknike kyçe si për programet e Software dhe Hardware ashtu edhe të çështjeve të komunikimit të të dhenave;
 - Te ofrojë shërbime të konsulcencës në lidhje me funksionimin, mbështetjen, mirëmbajtjen, përmirësimin, zhvillimin dhe instalimin e Sistemeve Teknologjike të Informacionit, ose të pajisjeve, ose të produkteve;
 - Te ndermarre projekte për instalimin, përfshirjen dhe përfundimin e plote të perberësve dhe pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit;
 - Te importojë dhe shesë në Tregun Vendas produkte të Software dhe Hardware që kanë lidhje me Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit të të Dhenave, si dhe elemente teknologjike të tjera përkatëse;

Bis

[Signature]

[Signature]

- Te siguroje sherbime administrative persa i perket infrastruktures se hostimit dhe funksionimit; te siguroje sherbime per llogari te Klientit per sa i perket proceseve te lidhura me natyren e produkteve dhe sherbimeve te Teknologjise se Informacionit te permendura me siper, te cilat Klienti eshte ne gjendje ti delegoje ose nenkontraktoje;

- Te siguroje trajnim teknik per kompanite ose individet e tregut vendas, ne lidhje me ceshtjet qe kane te bejne me Produktet e Teknologjise se Informacionit.

- 9.2 Shoqeria gezon te drejten qe ti afroje te gjitha sherbimet e siperpermendura si ne tregun vendas ashtu dhe ne ate nderkombetar.

NENI 10 ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

- 10.1 Organet Drejtuese te Shoqërise “HORIZON” SH.P.K. jane:
- Asambleja e Ortakeve.
 - Administratoret.
- 10.2 Administratoret e shoqerise emerohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Ortakeve.
- 10.3 Shoqëria do të administrohet nga Z.Panagiotis Stamatopoulos, shtetas grek, i biri i Athanasios, lindur ne Atika, Athine, Greqi, me 13/02/1974, me banim te perkohshem ne Rruga “Ismail Qemali”, Godina Samos Tower, Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes Nr. A 633130.
- 10.4 Modalitetet mbi perberjen dhe funksionimin e organeve te mesiperme percaktohen nga Statutit i shoqerise si dhe nga ligji “Per shoqerite tregtare”.

NENI 11


- 11.1 Te drejttat dhe detyrat e organeve drejtuese te shoqerise, ne menyre te specifikuar jane ato te percaktuara ne Statutin e saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

NENI 12 VITI FINANCIAR

- 12.1 Aktiviteti ekonomiko-financiar i shoqerise ndahet ne periudha te cilat zgjasin 12 muaj, kohe e cila si rregull fillon nga data 1 Janar deri ne daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te periudhes se pare, e cila fillon me daten e themelimit dhe perfundon ne daten 31 Dhjetor 2005.

NENI 13

- 13.1 Shoqëria duhet te mbaje nje Kontabilitet te rregullt per administrimin e



pasurise dhe gjithë veprimtarine ekonomiko-financiare te saj ne pajtim me kerkesat e ligjit perkates.

- 13.2 Bilanci Financiar i shoqerise nxirret mbi bazen e raportit me shkrim te Ekspertit Kontabel te autorizuar dhe atij te paraqitur nga Administratoret e saj, brenda dates 31 janar te vitit pasardhes dhe ato i paraqiten dhe miratohen me Vendim me shkrim nga Mbledhja e Asamblese se Ortakeve.

NENI 14

- 14.1 Fitimi Neto (Dividenti) i shoqerise "HORIZON" Sh.P.K., perlogaritet pasi nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, te jene zbritur humbjet e nevojshme te vitit te meparshem, vlera e shlyerjes se plote te detyrimeve taksore, tatimore apo fiskale, dhe cdo lloj detyrimi tjetër i shoqerise ndaj te treteve, si dhe lenien menjane te nje shume te pakten 1/20 te fitimit te rezervuar, e cila destinohet per formimin e nje Fondi Rezerve, te quajtur "Rezerve e Domosdoshme". Ky fitim ndahet midis Ortakeve, sipas perqindjes qe ze kontributi i tyre ne krijimin e Kapitalit Themeltar.

NENI 15

- 15.1 Shoqeria "HORIZON" Sh.P.K., mbaron si person juridik me mbarimin e afatit te percaktuar ne ket Akt ose per shkaqe te tjera , te cilat percaktohen ne Statut.

NENI 16


- 16.1 Me mbarimin si person juridik shoqeria kalon ne likuidim.
- 16.2 Te ardhurat e arketuara nga likuidimi i shoqerise pas shlyerjes se cdo detyrimi, ndahen ne mes te ortakeve, sipas vleres se kontributit te tyre ne formimin e kapitalit themeltar.

NENI 17

- 17.1 Ky Akt Themelimi miratohet unanimisht ne Mbledhjen e pare te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "HORIZON" Sh.P.K., mbi bazen e vullnetit te lire, te plote e te perbashket dhe me mirekuptim te ndersjellte.
- 17.2 Cdo mosmarreveshje si rregull, ortaket do ta zgjidhin me mirekuptim mes tyre, ne te kundert ata kane te drejte qe ta bejne ate objekt konflikti gjyqesor ne Gjykatën Kompetente te Juridksionit tokesor dhe lendor te rrethit te Tiranes.

NENI 18

- 18.1 Ky Akt Themelimi per krijimin e Shoqerise "HORIZON" Sh.P.K., u redaktua ne 5 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, dhe nenshkruhet ne prani te perkthyesit te gjuhes greke Arben Prasta, pa verejtje nga ortaket themelues, duke u vene emri, mbiemri dhe firma origjinale ne te gjitha kopjet e saj, autenticiteti i te cilave eshte legalizuar dhe nga Noteri.



ORTAKET THEMELUES
TE MBLEDHJES SE PARE TE ASAMBLESE SE ORTAKEVE

TE SHOQERISE

ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"HORIZON" SH.P.K



M. K. ...

Vasileios Stachos

Hilda Tesko

A. Peano